



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 2294 prot.

Shkodër, më 22.07.2021

V E N D I M

Nr. 238, datë 22.07.2021

"Për miratimin e ndryshimeve në Supplementet e Diplomave"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1, germa ''d''; Neni 91, pika 5; Statutit të USH-së neni 17, pika 6, gërma "r", Udhëzimin Nr.11, datë 2.4. 2020 "Për përcaktimin e përmbajtjes dhe të formës së suplementit të diplomës", në mbledhjen e tij të datës 22.07.2021

Vendosi:

1. Miratimin e ndryshimeve të mëposhtme në Supplementet e Diplomave:

a.te seksioni 1, lidhur me mbiemrat, duhet të shkruhen të dy mbiemrat, i dyti të vendoset në kllapa;

b.lidhur me emrat, mund të shkruhen të dy emrat kur personi mban dy emra;

c.te seksioni 2, hiqet historiku i USH-së dhe vendoset statusi i institucionit që lëshon diplomën; emri dhe fakulteti që e lëshon;

ç.te seksioni 3, termi ""niveli i studimeve"" zëvendësohet me termin ""niveli i kualifikimit"";

d.te seksioni 4.2 termi ""objektivat e të nxënit"" zëvendësohet me termin ""rezultatet e të nxënit"";

e. te seksioni 4.4 duhet të kemi një tabelë shpjeguese në lidhje me notat, si dhe duhet vendosur tema e diplomës;

f.te seksioni 4.4, tek ""klasifikimi i përgjithshëm"" të vendoset edhe nota mesatare, edhe niveli;

g.te seksioni 4.5 klasifikimi ka të bëjë me notën mesatare të ponderuar;

h.te seksioni 4.5 duhet të krijohet një dritare "Niveli i kualifikimit" dhe klasifikimi duhet të bëhet sipas legjislacionit shqiptar;

i.te seksioni 5.1 të vendosen mundësitë e studimeve të mëtejshme;

j.te seksioni 5.2 të lihen vetëm profesionet e rregulluara;

k.te seksioni 6 do të shtohet numri rendor i regjistrit bazë dhe numri rendor i regjistrimit të diplomës në regjistrin e lëshimit të diplomave;

l.te seksioni 6 të vendosen lëndët që nuk janë të përfshira në programin e studimit, por që studenti i ka dhënë ato, duke ndjekur shembullin e universiteteve evropiane;

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Prof. dr. Suzana GOLEMI

